

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar krijimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si një hap konkret dhe pozitiv drejt progresit të shtetit shqiptar për të përmbushur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe politikave antidiskriminim;
- Duke inkurajuar veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, garanton mbrojtjen efektive kundër diskriminimit dhe pabarazisë së subjekteve;
- Duke njohur dhe vlerësuar në vijim rolin e veprimtarisë së këtij institucioni të pavarur në funksion të zbatimit të të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për respektimin e parimit të trajtimit të barabartë, bazuar në një listë joshteruese arsyesh të përcaktuara në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, ku përfshihen (gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare ose filozofike, paaftësia fizike dhe mendore, orientimi seksual, gjendja ekonomike, shoqërore ose arsimore, gjendja shëndetësore, gjendja civile, gjendja familjare ose martesore, përkatësia prindërore, shtatzënia, mosha etj.);
- Duke shprehur vullnetin e tij maksimal për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionerit në drejtim të përmirësimit të legjislacionit vendas, sipas frymës së standardeve ndërkombëtare;

Vlerëson:

- Përpjekjet e këtij institucioni, edhe pse të limituar në kohë raportuese për vitin 2010, për sensibilizimin dhe njohjen me ligjin nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me organet shtetërore, si dhe me institucionet joqeveritare e organizmat ndërkombëtarë, që kontribuojnë në çështjen e mosdiskriminimit;

- Përkushtimin e Komisionerit për fillimin e funksionimit të institucionit dhe vendosjen e bazave të punës, sipas niveleve europiane;

- Përpjekjet e Komisionerit gjatë vitit 2010 për të rritur performancën e stafit drejtues dhe plotësimin e kapaciteteve funksionale të tij;

Konstaton se:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2010 është përqendruar në fushatën e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit, lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri, duke organizuar seminare, trajnime, tryeza të rrumbullakëta dhe veprimtari të tjera, me qëllim njohjen me ligjin nr.10

221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe detyrimet ligjore që rrjedhin prej tij;

- Ka miratuar aktet administrative, me qëllim mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit;

- I ka kushtuar rëndësi të veçantë vendosjes së bashkëpunimit me aktorët kombëtarë dhe

ndërkombëtarë që kanë objekt mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe, në mënyrë të veçantë, mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe ka pasur mbështetjen dhe asistencën e organizmave ndërkombëtarë në këtë fushë;

- Ka qenë i gatshëm për të ushtruar kompetencat e tij ligjore për dhënie mendimi, në fushën e

mbrojtjes nga diskriminimi, mbi bazën e kërkesës nga institucione publike;

- Ka filluar hartimin, në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtarë, të strategjisë së punës afatmesme dhe zhvillimin e institucionit për vitin pasardhës, duke përcaktuar përparësitë dhe objektivat që duhet të realizohen në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi;

- Gjatë vitit 2010, Komisioneri ka marrë në shqyrtim për herë të parë 4 ankesa me pretendim për

diskriminim për shkaqe të ndryshme dhe ka vijuar me procedurat e parashikuara ligjore;

- Komisioneri duhet të jetë i vetëdijshëm për ekzistencën e fenomenit të shfaqur të mosrespektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në nivel qendror dhe vendor

në tërësinë e territorit të Republikës së Shqipërisë për kategori të veçanta të shoqërisë shqiptare.

Për vitin 2011 Kuvendi i Shqipërisë kërkon:

- Nxitjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për një angazhim të plotë intensiv dhe të efektshëm të mbrojtjes nga diskriminimi dhe të gjitha formave të shfaqjes së tij ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj;

- Marrjen e masave urgjente për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit me vendosjen e rregullave të gjithanshme, si dhe kontrollin e rreptë të zbatimit të tyre;

- Rritjen e rolit sensibilizues të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për informimin e shtetasve, lidhur me misionin dhe kompetencat që ky institucion ushtron për mbrojtjen e parimit të barazisë dhe antidiskriminimit në tërësi;

- Vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me median e shkruar dhe atë vizive, për të

mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të gjithë shtetasit shqiptarë, si dhe me subjektet e tjera, siç është përcaktuar në ligj;

- Organizimin e veprimtarive në formatin “Ditë të hapura”, për të siguruar aksesin e nevojshëm të publikut, si dhe tryezave të rumbullakëta, të hapura, për legjislacionin e barazisë kushtetuese dhe ligjore të shtetasve;

- Metodologjia, mënyra e raportimit të ardhshëm vjetor të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të pasqyrojë një analizë të çështjeve, të fenomenologjisë dhe tipologjisë së tyre, si dhe përgjithësime mbi bazën e praktikave të kryera. Ky raport duhet të deklarojë zyrtarisht konkluzionin mbi gjendjen e respektimit të antidiskriminimit për vitin në vijim dhe të parashtrojë rekomandime për proceset parandaluese dhe nevojat e mëtejshme për përmirësimin e punës për zbatimin e ligjit;

- Angazhim maksimal në drejtim të bashkëveprimit dhe koordinimit intensiv dhe periodik të

Komisionerit me institucionet qeveritare në nivel qendror dhe vendor;

- Vendosjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit të KMD-së me institucionet e tjera të pavarura, që kanë objekt fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe me institucionet akademike, shoqërinë civile, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare që angazhohen të kontribuojnë në çështjen e mosdiskriminimit;

- Shtimin e kontributit në dhënien e mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me çështjet e diskriminimit;
- Bashkëpunim të veçantë me organet e gjyqësorit në shkëmbim e referim rastesh konkrete, për zgjidhjen më të mirë të ankesë-kërkesave;
- Në kuadër të zgjedhjeve vendore, të zhvillojë komunikim informues dhe edukues me kategoritë vulnerabël të grave në zonat e thella rurale, si dhe me komunitetet e pakicave, me qëllim garantimin e ushtrimit të së drejtës politike për të votuar dhe për t'u zgjedhur.

7 korrik 2011

KRYETARE

Jozefina Topalli (Çoba)